

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Gani Zabeli, kryetar i kolegjit, gjyqtarët Hashim Çollaku dhe Shqipe Qerimi, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Kimete Veseli, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit J.B., nga fshati ... Komuna e Gjakovës, për shkak të veprës penale të kanosjes nga neni 185 par.2 lidhur me par.1 të KPK, duke vendosur sipas ankesës së mbrojtësit të akuzuarit, J.B., av. F.B., të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë, P.nr.183/2017, të datës 27.04.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur me 14.08.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e mbrojtësit të akuzuarit J.B., av. F.B., kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë, P.nr.183/2017, të datës 27.04.2018, **vërtetohet**.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e ankimuar të Gjykatës Themelore në Gjakovë, P.nr.183/2017, të datës 27.04.2018, i akuzuari J.B. është shpallur fajtor, për shkak të veprës penale të kanosjes nga neni 185 par.2 lidhur me par.1 të KPK, dhe i është shqiptuar dënimi me gjobë në shumën prej 800 (tetëqind) €, të cilin dënim është obliguar që ta paguajë në afat prej 90 (nëntëdhjetë) ditëve, pasi që aktgjykimi të bëhet i plotfuqishëm, në të kundërtën në kuptim të nenit 46 par.3 të KPK-së, dënimi i shqiptuar me gjobë, do të zëvendësohet në dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 40 (dyzetë) ditëve, duke u llogaritur për çdo ditë të kaluar në burg nga 20 (njëzetë) €.

I dëmtuari I.B. për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, është udhëzuar në kontestin e rregullt juridiko-civil.

Është obliguar i akuzuari që të paguajë shpenzimet e procedurës penale sado që të jenë ato sipas llogarisë së bërë në arkë të gjykatës, si dhe paushallin gjyqësor në shumën prej 50 (pesëdhjetë) €, të gjitha këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimi, në afat ligjor ka ushtruar ankesë, mbrojtësi i të akuzuarit J.B., av. F.B., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe vendimit lidhur me sanksionin penal, duke propozuar që ankesa të aprovohet si e bazuar ndërsa aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet, dhe i akuzuari të lirohet nga akuza, ose i njëjti të anulohet dhe çështja penale ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe vendosje.

Prokuroria e Apelit në Prishtinë me shkresën PPA/II.nr.742/2018, të datës 19.07.2018, duke u sqaruar përkitazi me ankesën e mbrojtësit të akuzuarit J.B., av. F.B., ka propozuar që e njëjta të refuzohet si e pa bazuar, kurse aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit në kuptim të nenit 394 të KPPK, duke vlerësuar pretendimet ankimore nga ankesa e mbrojtësit të akuzuarit, propozimit me shkrim të Prokurorisë së Apelit në Prishtinë, si dhe shkresave tjera të lëndës ka gjetur se:

Ankesa e mbrojtësit të akuzuarit J.B., av. F.B., nuk është e bazuar.

Sipas ankesës së mbrojtësit të akuzuarit, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, është ankimuar për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, duke theksuar se gjykata e shkallës së parë me rastin e vendosjes në këtë çështje penale, ka paraqitur qartë dhe në mënyrë të plotë se cilat fakte ishin vendimtare për marrjen e aktgjykimit, mirëpo nuk ka dhënë arsytim se për çfarë arsyeje iu ka falur besimi dëshmitave të caktuar dhe për çfarë arsye, kurse nuk ka paraqitur arsye se pse nuk i ka falur besim mbrojtjes, duke theksuar se deklaratimet e mbrojtjes janë të pa bazuara. Gjithashtu të gjitha rrethanat ishin të pa bazuara me rastin e vendosjes, duke mos dhënë arsyetimin e saj në kuptim të dispozitave ligjore, sikurse parashihet dispozita përkatëse ligjore, ashtu që aktgjykimi është marrur në kundërshtim me nenin 384 paragrafi 1 pika 1.8 të KPRK, sepse i njëjti bazohet në prova të pa pranueshme dhe të pa vërtetuara, që rezulton se me asnjë provë materiale të besueshme nuk vërtetohet se i akuzuari ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë, kurse në mungesë të provave krijohet bindja se me ndezjen e motor sharrës nga i akuzuari J. është kryer vepra penale kanosja nga neni 185 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPRK.

Kolegji i kësaj gjykate e ka shqyrtuar dhe vlerësuar aktgjykimin e ankimuar, sipas ankesës së ushtruar, si dhe shkresat e tjera të lëndës, në kuptim të nenit 394 të KPPK, për të cilat shkelje përkujdeset edhe sipas detyrës zyrtare, dhe ka ardhur në përfundim se dispozitivi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, është i qartë, i kuptueshëm dhe në harmoni me vetveten, dhe me arsyetimin e të njëjtit, sepse përmban arsyet lidhur me faktet vendimtare, të cilat karakterizojnë veprën penale të kanosjes nga neni 185 par 2 lidhur me par 1 të KPK, sepse gjykata e shkallës së parë me të gjitha provat personale dhe materiale sikurse janë, deklaratat e të dëmtuarit I.B., deklaratat e dëshmitarëve A.B., S.S., raporti i oficerit A.K. i dt.24.09.2016, raporti me numër të rastit 2016-EA-1016, të dt.24.09.2016, raporti fillestar i inicimit me nr. 2016-EA-1016, të dt.24.06.2016, që të gjitha pasi që janë proceduar kanë vërtetuar se në veprimet e të akuzuarit janë formuluar elementet inkriminuese të veprës penale për të cilën është shpallur fajtor i akuzuari. Gjithashtu, kolegji i kësaj gjykate ka ardhur në përfundim, se aktgjykimi i ankimuar është punuar në kuptim të dispozitës ligjore nga neni 370 par 6 dhe 7 të KPPK, sepse dispozitat përkatëse ligjore janë respektuar në përpikëri, ngase aktgjykimi përmban formën e kërkuar me shkrim, se gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar ekzistimin e veprës penale, duke vërtetuar se cilat fakte janë të vërtetuara apo të pa vërtetuara, si dhe ka dhënë arsye të mjaftueshme dhe sqaruar se për çfarë arsye konsiderohen të vërtetuara, apo të pa vërtetuara si dhe ka vlerësuar saktësinë e të gjitha provave në këtë çështje penale përkitazi me ekzistimin e veprës penale si dhe përgjegjësisë penale të akuzuarit, ashtu që kolegji i kësaj gjykate vie në përfundim se aktgjykimi i ankimuar si i tillë është i pranueshëm dhe i bazuar në ligj.

Sipas ankesës së mbrojtësit të akuzuarit, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është ankimuar për shkak të shkeljes së ligjit penal, duke theksuar se është bërë shkelja e ligjit penal në kuptim të nenit 358 par 1 pika 1.2 me që ekzistojnë rrethana që përjashtojnë përgjegjësinë penale të akuzuarit për kryerjen e veprës penale, sepse rezulton se nuk është kryer vepra penale e kanosjes ndëzja e motor sharrës, me që kjo veprë nuk është e sanksionuar si veprë penale, si

dhe nuk ekzistojnë elementet e përgjegjësisë penale, andaj gjykata në këtë rast pa u mbështetur në prova materiale dhe fakte gjykon dhe dënon si përgjegjës të veprës penale personin, që rezulton se ka rënë në kundërshtim me ekzistimin e veprës penale, që nënkupton se janë bërë shkeljet e ligjit penal.

Kolegji i kësaj gjykate, e ka shqyrtuar dhe vlerësuar aktgjykimin e ankimuar, si dhe shkresat e tjera të lëndës, dhe ka ardhur në përfundim se aktgjykimi i ankimuar nuk përfshihet me shkeljet e ligjit penal të parapara në kuptim të neni 385 të KPPK, ngase me të gjitha provat e administruara në shqyrtim gjyqësor janë vërtetuar elementet inkriminuese të veprës penale e cila i vihet në barrë të akuzuarit, se vepra penale për të cilën është akuzuar i akuzuari parashihet me ligjin e aplikueshëm, se në këtë çështje penale janë vërtetuar të gjitha elementet qenësore të veprës penale të kryer, si dhe dashjen si formë të kryerjes së saj, se nuk ekzistojnë rrethana që përjashtojnë të akuzuarin nga përgjegjësia penale dhe ndjekja penale, se gjykata në mënyrë të drejtë ka zbatuar ligjin i cili ka qenë aplikueshëm në kohën e kryerjes së veprës penale, se gjykata ka vepruar në kuadër të kompetencës ligjore, andaj, aktgjykimi i ankimuar është i pranueshëm për kolegjin e kësaj gjykate.

Sipas ankesës së mbrojtësit të akuzuarit, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, është ankimuar për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, ngase asnjëherë gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk është kontestuar fakti që i akuzuari ta ketë ndezur motor sharrën, mirëpo sharra është ndezur që ta liroj rrugën në pyll për prerjen e trungjeve, me që rruga e pyllit është një drejtimshë. Gjykata e shkallës së parë nuk vlerëson drejtë dhe saktë gjendjen faktike për të zbardhur të vërtetën ashtu që nga kjo rezulton se gjykata e shkallës së parë nuk vërteton gjendjen faktike, dhe në mungesë të provave materiale, përkritazi me veprën penale për të cilën akuzohet i akuzuari- të kanosjes, gjykata e shkallës së parë vetëm paragjykon se e njëjta është kryer. Nga kjo rezulton se nuk janë analizuar dhe vlerësuar, dëshmitë duke mos argumentuar dashjen, qëllimin, motivin dhe pa e përmbushur asnjë element qenësor të veprës penale. Në kundërshtim me gjendjen faktike dhe nën paragjykim e shpall fajtor dhe i shqipton dënimin sikurse në dispozitiv të aktgjykimit, pa i vlerësuar në masë të duhur dëshmitarin A.B., i cili në dëshminë e tij të dhënë në Stacionin Policor në Gjakovë, me datën 24.09.2016, në faqen 2 rreshti 7 ka deklaruar, duke vërtetuar me nënshkrimin e tij se që vëllai e ka ndezur motor sharrën dhe ju ka ofruar djalit të tij, deri tek qafa. Mendojmë së ky dëshmitarë fillimisht është propozuar në kundërshtimin me dispozitën ligjore nga neni 124 par.1 të KPRK, në të cilin parashihen dëshmitarët për të cilët besohet se mund të japin informata për veprën penale, ashtu që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë si i tillë është i papranueshëm dhe nuk e ka mbështetjen e duhur ligjore.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, e ka shqyrtuar dhe vlerësuar aktgjykimin e ankimuar, ankesën e ushtruar, si dhe shkresat e tjera të lëndës, dhe ka ardhur në përfundim se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike kur të akuzuarin e ka shpallur fajtor për veprën penale e cila i vihet në barrë, dhe i ka shqiptuar dënimin përkatës ligjor, sepse nga provat e administruara dhe të vlerësuara në shqyrtimin gjyqësor është vërtetuar se i akuzuari me dt.24.09.2016, rreth orës 09:00, në afërsi të pyllit të A., ka qenë me traktor duke u kthyer në shtëpi nga pylli ku kishte prerë drunjtë, është takuar me të dëmtuarin I., i cili gjithashtu ka qenë me traktor, dhe pasi që ka qenë rruga e ngushtë, i akuzuari ka insistuar që i dëmtuari ti liron rrugën dhe pasi që i dëmtuari i thotë se do ta thërras prindin e tij që ta liron rrugën, i akuzuari i është kanosur me fjalët do të privojë nga jeta, duke ndezë motor sharrën me të cilin i afrohet të dëmtuarit duke i thënë “s’ke qare pa e liru rrugën se të mbysë, ta prej

qafën”, me ç’rast tek i njëjti shkakton frikë dhe ankth, fakt ky i cili është vërtetuar edhe nga ana e mbrojtësit të akuzuarit, av. F.B., i cili në fjalën përfundimtare ka deklaruar se asnjëherë gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor nuk është kontestuar fakti se i akuzuari ta ketë ndezur motor sharrën, duke theksuar se një gjë të tillë e ka bërë me qëllim të lirimit të rrugës në pyll për prerjen e drunjtëve, pasi që rruga e pyllit është një drejtimesh. Gjithashtu, gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur ia ka falur besimin deklaratës së të dëmtuarit I.B., i cili ka theksuar se i akuzuari e ka kërcënuar që ta liroj rrugën, mirëpo i njëjti nuk ka mundur që ta lirojë të njëjtën, pasi që kjo rrugë ka qenë e ngushtë dhe përpjete e madhe, dhe se i akuzuari e ka ndezur motor sharrën duke iu drejtuar me fjalët “nuk ki qare pa ma leshu rrugën ose do të mbysë, deklaratë kjo e cila përputhet me deklaratën e dhënë në polici nga i dëmtuari, dhe se kjo deklaratë nuk është kundërshtuar as nga i akuzuari J., apo mbrojtësi i tij gjatë shqyrtimit gjyqësor. Po ashtu, gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur nuk ia ka falur besimin deklaratës së mbrojtësit të akuzuarit, pasi që kjo deklarata ka qenë përpjekje për të ikur apo për tu zvogëluar përgjegjësia penale e të akuzuarit, ashtu që, pranë një gjendje të këtyllë faktike, gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur të akuzuarin e ka shpallur fajtor për veprën penale e cila i vihet në barrë, dhe se aktgjykimi i ankimuar si i tillë është i pranueshëm edhe për kolegjin e kësaj gjykate.

Sipas ankesës së mbrojtësit të akuzuarit, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është ankimuar për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, duke mos cekur ndonjë arsye për këtë bazë ankimore, mirëpo kolegji i kësaj gjykate të njëjtin e ka shikuar sipas detyrës zyrtare, dhe ka ardhur në përfundim se nga ana e gjykatës së shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të plotë është vërtetuar gjendja faktike, se aktgjykimi i ankimuar nuk përfshihet me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, si dhe shkeljet e ligjit penal në dëm të akuzuarit, andaj, kolegji vie në përfundim se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë me rastin e marrjes së vendimit për dënimin, caktimit të llojit dhe lartësisë së tij, në kuptim të nenit 73 të KPK, sikurse janë rrethanat lehtësuese, se i akuzuari ka patur sjellje korrekte në gjykatë, se është mbajtës i familjes, ndërsa rrethana rënduese nuk gjeti, e duke mos gjetur ndonjë rrethanë posaçërisht lehtësuese, kolegji i kësaj gjykate, është i bindur se me dënimin e shqiptuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij i paraparë me nenin 41 të KPK, që të parandaloj kryerësin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëj rehabilitimin e tij, të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëj kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale, dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Nga sa u tha më lartë e në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPPK, u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PA1. nr.736/2018 të datës 08.08.2018

Bashkëpunëtorja profesionale
Kimete Veseli

Anëtarët e kolegjit
Hashim Çollaku

Kryetari i kolegjit
Gani Zabeli

Shqipe Qerimi